REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË

Nr. 5248/2 Prot. Lezhë, më 27.04.2026

NJOFTIM

"PËR ORGANIZIMIN E DËGJESËS PUBLIKE PËR DISA NDRYSHIME NE VKB NR 104, DATË 26.11.2025 "PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË TAKSAVE, TARIFAVE TË SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE ATO ADMINSTRATIVE, LEHTËSIRAVE FISKALE, STRUKTURAT E VJELJES SË TYRE DHE ATO TË VENDOSJES SË PENALITETEVE NDAJ KUNDRAVAJTËSVE"

Mbështetur në Ligjin 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" dhe Rregulloren " Për Organizimin, Funksionimin, Detyrat dhe Kompetencat e Administratës së Bashkisë Lezhë" e miratuar me VKB Nr. 393 datë 18.07.2022 ,

Ju njoftojmë për zhvillimin e dëgjesës publike në lidhje me miratimin e rregullores për kriteret dhe kushtet që agjencitë/shtëpitë funerale duhet të plotësojnë për ushtrimin e veprimtarisë së tyre.

Qëllimi i dëgjesës publik për disa ndryshime në VKB nr. 104, datë 26.11.2025 "Për miratimin e nivelit të taksave, tarifave të shërbimeve publike dhe ato administrative, lehtësirave fiskale, strukturat e vjeljes së tyre dhe ato të vendosjes së penaliteteve ndaj kundravajtësve", është të përfshijë qytetarët dhe bizneset në shqyrtimin e shtimit të gjobave për agjencitë funerale dhe menaxhimin e mbetjeve, me synim rritjen e respektimit të rregullave, përmirësimin e shërbimeve dhe marrjen e vendimeve sa më të drejta dhe transparente.

Dëgjesa publike do të zhvillohet në datën **26.05.2026 ora 11:00 në sallën e Bibliotekës "At Gjergj Fishta" Lezhë**.

Rekomandimet mund t'i dërgoni deri në datën 26.05.2026, në adresën zyrtare të email info@lezha.gov.al.

KRYETARI

Pjerin NDREU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA LEZHË